



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2463/Prot.

Tiranë, më 10.10.2025

VENDIM

Nr. 309, Datë 10.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E QËNDRIMIT NË DETYRË TË MAGJISTRATIT  
LAZËR ÇARDAKU”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

|                    |            |
|--------------------|------------|
| 1. Mirela BOGDANI  | Kryetar    |
| 2. Erind GERMENJI  | Zv/kryetar |
| 3. Sokol STOJANI   | Anëtar     |
| 4. Zeqir HODA      | Anëtar     |
| 5. Arta MANDRO     | Anëtar     |
| 6. Ledina RIZA     | Anëtar     |
| 7. Moisi DUDA      | Anëtar     |
| 8. Vatë STAKA      | Anëtar     |
| 9. Olger EMINAJ    | Anëtar     |
| 10. Erind MERKURI  | Anëtar     |
| 11. Erion FEJZULLA | Anëtar     |

Në mbledhjen plenare të datës 10.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit Lazër Çardaku”**

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:**

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2463 prot., datë 03.10.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

## V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim, *Këshilli*) është administruar Kërkesa datë 14.04.2024 (regjistruar me nr. 1192 prot., datë 14.04.2025), e magjistratit Lazër Çardaku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt vijimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit deri në plotësimin e moshës 70 vjeç.
2. Kjo kërkesë bazohet në nenin 64, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (në vijim, *Ligji për Statusin*), ku parashikohet se:  
  
*“5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë”.*
3. Prokurori Lazër Çardaku është i datëlindjes 06.11.1958, dhe mbush moshën për pension pleqërie (67 vjeç) në datën 06.11.2025. Kërkesa e tij për vijimin e qëndrimit në detyrë është paraqitur me datë 14.04.2025, duke respektuar afatin e 6-mujor për paraqitjen e saj.
4. Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, me Vendimin nr. 812, datë 08.11.2024, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Lazër Çardaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vendim i cili është ankimuar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga vetë subjekti.
5. Kërkesa e mësipërme për shtyrjen e moshës së pensionit për prokurorin Lazër Çardaku u shqyrtua në mbledhjen e dt. 03.10.2025, në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, anëtarët e të cilit mbajtën qëndrime të ndryshme.
6. Lidhur me këtë kërkesë, shumica e anëtarëve të Këshillit vlerëson se, neni 64, pikat 1, germa “c” dhe 5, i Ligjit për Statusin parashikon se cilat janë rastet konkrete për mbarimin e statusit të magjistratit. Kjo dispozitë njeh të drejtën e magjistratit për të ruajtur statusin dhe për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës 70 vjeç, duke paraqitur kërkesë brenda afatit ligjor prej 6 muajsh para plotësimit të moshës së pensionit, afat i cili është respektuar nga kërkuesi.
7. Është i njohur edhe fakti se, ndaj Vendimit nr. 812, datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra, kërkuesi në cilësinë si subjekt i rivlerësimit kalimtar ka ushtruar ankim dhe është në pritje të shqyrtimit të tij nga Kolegji i Posaçëm i

Apelimit. Ndërsa, ndërsa institucioni i Komisionerit Publik nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi. Në këto rrethana, prokurori Lazër Çardaku vazhdon të gëzojë statusin e magjistratit.

8. Qëndrimi i Këshillit lidhur me kërkesën e prokurorit Lazër Çardaku nuk duhet të paragjykojë vendimin e mundshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për konfirmimin në detyrë të magjistratit dhe as të cenoje të drejtën e tij për të qëndruar në detyrë përtej moshës 67 vjeç. Mospranimi i kërkesës për shtyrjen e moshës së pensionit dhe deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit nga ana e Këshillit do të cenonte të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të kërkuarit Lazër Çardaku, për rrjedhojë edhe pasjen e statusit të magjistratit deri në momentin e shqyrtimit të ankimit nga ana e këtij organi.
9. Në praktikën e tij të mëparshme në një situatë të ngjashme me sa më sipër, Këshilli ka miratuar qëndrimin e prokurorit në detyrë edhe pasi kishte mbushur moshën 67 vjeç. Duke miratuar kërkesën e prokurorit Lazër Çardaku, Këshilli ruan të njëjtën qëndrim të mëparshëm të tij.
10. Në vlerësimin e Këshillit, qëndrimi në detyrë i magjistratit përtej moshës 67 vjeç nuk ka lidhje me vakancat momentale të sistemit të prokurorisë dhe parashikimi i nenit 64, pika 5, të Ligjit për Statusin përmban rregullim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të situatës në fjalë. Magjistrati mund të vijojë të ushtrojë detyrën deri në mbushjen e moshës 70 vjeç dhe i takon vetë magjistratit të bëjë këtë vlerësim, nëse do të vijojë të ushtrojë detyrën apo të ndërprerë ushtrimin e saj duke dalë në pension. Prokurori Lazër Çardaku ka një përvojë të konsiderueshme prej 27 vitesh në profesion dhe nëse do të konfirmohet në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, ai do të vijojë të kontribuojë me këtë përvojë në sistemin e prokurorisë.
11. Prokurori Lazër Çardaku vijon të gëzojë statusin e magjistratit deri në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit si dhomë e Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve përkatëse në Kushtetutë dhe në Ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
12. Në pakicë, disa anëtarë të Këshillit mbajtën qëndrimin se e drejta për të shtyrë moshën e daljes në pension përtej moshës 67 vjeçare është një e drejtë subjektive në favor të kërkuarit, prokurorit Lazër Çardaku. Kjo kërkesë nuk duhet të miratohet në kushtet kur ai nuk e ushtron detyrën për shkak të pezullimit nga detyra (me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që prej nëntorit të vitit 2024). Qëndrimi i mëtejshëm në detyrë nuk e ndihmon efektivisht Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për më tepër në kushtet kur nuk mund të parashikohet afati i shqyrtimit të ankimit dhe disponimi me vendimmarrjen konkrete nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 149/1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenin 64, pikat 1, germa “c” dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet

e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

### V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magistratit Lazër Çardaku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.
2. Ky vendim i njoftohet Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe prokurorit Lazër Çardaku.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.10.2025.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
**Mirela Bogdani**

**ZV/KRYETAR**  
**Erind Gërmenji**

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**  
**( kundër )**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**

**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

**ANËTAR**  
**Erind Merkuri**  
**( kundër )**

**ANËTAR**  
**Erion Fejzulla**

## MENDIM PAKICE

1. Ne, anëtarët Sokol Stojani dhe Erind Mercuri, duke qenë se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për pranimin e kërkesës për shtyrjen e moshës së pensionit për z. Lazër Çardaku, e shohim të nevojshme që të dalim me qëndrim pakice duke argumentuar edhe qëndrimin tonë, në lidhje me këtë rast.

2. Në mënyrë të përmbledhur, shumica e Këshillit ka vlerësuar se neni 64, pika 5, e Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, i njeh magjistratit të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në moshën 70 vjeç, me kusht që kërkesa të paraqitet brenda afatit ligjor prej 6 muajsh para mbushjes së moshës 67 vjeç. Sipas shumicës, dispozita nuk i jep Këshillit kompetencë diskrecionare për ta refuzuar këtë kërkesë, por thjesht e ngarkon atë me detyrimin formal për të konstatuar vijimin e statusit nëpërmjet vendimit. Në rastin konkret, shumica ka arsyetuar se prokurori Lazër Çardaku vijon të gëzojë statusin e magjistratit, pasi vendimi i KPK-së për shkarkim nuk ka marrë formë të prerë dhe është në shqyrtim nga KPA-ja. Për rrjedhojë, Këshilli nuk duhet të paragjykojë rezultatin e këtij procesi dhe as t'i mohojë të drejtën për të ushtruar detyrën deri në moshën 70 vjeç. Në përputhje me këtë interpretim dhe me praktikën e mëparshme, shumica ka vendosur miratimin e kërkesës së prokurorit për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç.

3. Ky qëndrim i shumicës, mendojmë se nuk përputhet me kuptimin e termave ligjorë të përdorura nga ligjvënësi në këtë rast. Kështu, Ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, në nenin 64, pika 1, gërma “c” dhe pika 5, parashikon se *“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ... c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; ... 5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës”*.

4. Siç mund të konstatohet nga përmbajtja e kësaj dispozite, një nga rastet kur përfundon statusi i magjistratit është edhe kur ai del në pension. Për daljen në pension, vetë dispozita parashikon dy situata, e para me mbushjen e moshës 67 vjeçare dhe e dyta me mbushjen e moshës 70 vjeçare. Nga mënyra si është formuluar dispozita nuk le asnjë dyshim, që në rastin e parë, me mbushjen e moshës 67 vjeçare, dalja në pension është, si rregull, e detyrueshme.

5. Përsa i përket rastit të dytë, atë të shtyrjes së moshës së pensionit, dispozita e sipërcituar, përmend tre kushte, e para paraqitjen e kërkesës nga vetë magjistrati, e dyta paraqitjen e saj jo më vonë se 6 muaj përpara se ai/ajo të mbushë moshën për pension (67 vjeç) dhe e treta vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në rastin e magjistratëve, profili prokuror). Ekzistenca e këtyre tre elementëve, në vetvete tregon qartazi se shtyrja e moshës së pensionit për magjistratin, nuk është një “noterizim” mekanik që duhet të bëjë Këshilli.

6. Për të arritur në një kuptim të drejtë të dispozitave ligjore, si edhe të këtyre tre elementëve, ne si pakicë, e çmojmë të nevojshme që të bazohemi në “rregullat e interpretimit” (*Canons of interpretation*), të cilat shumica ka dështuar që t'i aplikojë.

7. Kështu, nëse i referohemi Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, rezulton se në nenin 64, pika 5, fjalia e dytë, ligjvënësi ka përdorur foljen “mund”. Duke qenë se nga vetë ligjvënësi nuk është vendosur asnjë përkufizim për këtë rast (*Interpretive-Direction Canon*), atëherë, siç edhe Këshilli ka vepruar në raste të tjera,<sup>1</sup> duhet t’i referohet rregullit të kuptimit të zakonshëm të normës (*Ordinary-Meaning Canon*), ku Fjalori i Gjuhës Shqipe i vitit 2006 (botim i Akademisë së Shkencave), ndër të tjera na jep këtë kuptim “***mund*** *jokal., -a, -ur ... 2. si pj. mbase, ndoshta: mundet, ashtu qoftë!*”. Pra, siç rezulton nga ky përkufizim gjuhësor, përdorimi i foljes “mund”, tregon që jemi përpara një pushteti diskrecionar të Këshillit dhe për rrjedhojë, ky institucion nuk është i detyruar që të pranojë domosdoshmërisht kërkesa të tilla.

8. Ndodhur përballë këtij kuptimi gjuhësor, atëherë rezulton se jemi përpara një tjetër rregull interpretimi dhe konkretisht atij “Detyrues/Lejues”, ku fjalët detyruese vendosin një detyrim, ndërsa fjalët lejuese japin një diskrecion (*Mandatory/Permissive Canon*). Ky rregull interpretimi është pasqyruar mjaft qartë edhe në “Manualin për hartimin e legjislacionit”, në të cilin shpjegohet se “**2.19 Foljet modale.** 340. Duhet treguar kujdes që foljet modale të përdoren gjithmonë në mënyrë konsistente në varësi të faktit nëse ato tregojnë një urdhër apo lejojnë diçka. Përkatesisht, përdoret zakonisht folja gjysmëndihmëse me vlerë modale “duhet” e cila vendoset përpara një foljeje tjetër për të plotësuar kuptimin e kësaj të fundit, ndërsa folja “mund” ka një kuptim më diskrecionar. Përdorimi jo i saktë nga pikëpamja gramatikore apo jo në mënyrë të njëjlojtë i këtyre foljeve shkakton paqartësi në lidhje me karakterin lejues apo urdhërues të dispozitës”.<sup>2</sup> Nisur nga ky shpjegim është e qartë që ligjvënësi, termin “mund”, prezumohet se e ka përdorur në mënyrën e drejtë dhe të saktë gramatikore, duke sjellë për rrjedhojë që nëpërmjet kësaj foljeje, i ka dhënë diskrecion Këshillit për të vendosur, por jo për të detyruar atë.

9. Kjo qasje mbështet edhe në jurisprudencën autoritare të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila, në një sërë vendimesh të saj dhe konkretisht tek vendimi më i fundit, në çështjen “*Biden v. Texas*, 597 U. S. \_\_\_\_ (2022)”, ndër të tjera ka mbajtur qëndrimin se “*Kjo Gjykatë ka theksuar në mënyrë të përsëritur se përdorimi i fjalës ‘mund’ nënkupton qartësisht diskrecion.*”<sup>3</sup>

10. Në vijim të arsytimit të mësipërm, duhet theksuar se përdorimi i foljes “mund” në nenin 64, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, lidhet ngushtësisht edhe me parashikimin e afatit 6-mujor për paraqitjen e kërkesës për shtyrjen e moshës së daljes në pension. Ky afat nuk është i vendosur në mënyrë formale apo rastësore, nga ana e ligjvënësit, por përbën një element thelbësor të mënyrës si është formuluar dispozita dhe të strukturës së saj, duke na treguar qartë se kemi të bëjmë me një kompetencë diskrecionare të Këshillit dhe jo me një detyrim për pranimin e kërkesës së paraqitur.

<sup>1</sup> Në vendimin nr.65, datë 10.4.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, paragrafi nr.169, arsyetohet se: “Për këtë arsye, në mungesë të një përkufizimi ligjor të këtij termi (*Interpretive-Direction Canon*), Këshilli duhet që t’i referohet rregullit të kuptimit të zakonshëm të normës (*Ordinary-Meaning Canon*), bazuar në përkufizimet që jep Fjalori i Gjuhës Shqipe, ku botimi më i fundit është ai i vitit 2006, hartuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Përdorimi i këtij rregulli interpretimi, dhe i Fjalorit të Gjuhës Shqipe si mjet ndihmës, bën që analiza e Këshillit të jetë sa më objektive, duke shmangur gjykimet personale mbi vendimmarrje të caktuara”.

<sup>2</sup> “Manual për hartimin e legjislacionit”, botimi i 3-të, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 2021, fq.128-129.

<sup>3</sup> Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë e SHBA i referohet edhe vendimeve në çështjet *Opati v. Republic of Sudan*, 590 U. S. \_\_\_\_, \_\_\_\_ (2020); *Weyerhaeuser Co. v. United States Fish and Wildlife Serv.*, 586 U. S. \_\_\_\_, \_\_\_\_ (2018); *Halo Electronics, Inc. v. Pulse Electronics, Inc.*, 579 U. S. \_\_\_\_, \_\_\_\_ (2016); *Jama v. Immigration and Customs Enforcement*, 543 U. S. 335, 346 (2005); *Martin v. Franklin Capital Corp.*, 546 U. S. 132, 136 (2005) dhe *Fogerty v. Fantasy, Inc.*, 510 U. S. 517, 533 (1994); ku del qartësisht se në të gjitha rastet është mbajtur i njëjti qëndrim.

11. Kështu, nëse do të pranohej interpretimi i shumicës, sipas të cilit Këshilli ka vetëm një rol “noterizues” dhe jo vlerësues, atëherë afati 6-mujor i përcaktuar nga dispozita, do të ishte i panevojshëm dhe i pakuptimtë. Ne si anëtarë në pakicë, vlerësojmë se nuk do të kishte asnjë arsye apo logjikë që ligjvënësi të parashikonte një periudhë kaq të gjatë, brenda së cilës Këshilli do të vlerësonte kërkesën e paraqitur, nëse shtyrja e moshës së pensionit dhe qëndrimi në detyrë do të ishte i garantuar për çdo magjistrat. Përkundrazi, vetë ekzistenca e këtij afati tregon se ligjvënësi ka dashur t’i japë Këshillit një hapësirë të arsyeshme kohe për të vlerësuar kërkesën, duke shqyrtuar jo vetëm përmbushjen e kushteve formale, por edhe faktorë të tjerë objektivë që lidhen ndër të tjera me interesin e sistemit, nevojat institucionale, performancën e magjistratit dhe integritetin e tij profesional.

12. Në këtë kuptim, afati 6-mujor nuk është thjesht një detyrim procedural për magjistratin, por një garanci kohore për Këshillin, që ky i fundit të ushtrojë në mënyrë të plotë pushtetin e tij vlerësues dhe diskrecionar. Një dispozitë ligjore që parashikon një afat të tillë, relativisht të gjatë, nuk mund të interpretohet sikur përcakton një detyrim mbi mënyrën e vendimmarrjes së Këshillit, pasi koha e lënë në dispozicion e humbet kuptimin e saj. Përkundrazi, ky afat fiton kuptim juridik vetëm në kontekstin e ushtrimit të një pushteti diskrecional, ku Këshilli, brenda një periudhe të përcaktuar, duhet të analizojë të gjitha rrethanat dhe të vendosë nëse ekziston interesi publik dhe institucional për shtyrjen e qëndrimit në detyrë.

13. Nëse ligjvënësi do të kishte dashur që zgjatja e moshës së pensionit të ishte një e drejtë që nuk i nënshtrohej asnjë vlerësimi, atëherë do ta kishte formuluar në një mënyrë të tillë, “*Magjistrati, me kërkesën e tij, qëndron në detyrë deri në moshën 70 vjeç*”. Por megjithëse e kishte këtë mundësi, ligjvënësi duke zgjedhur që të përdorë foljen “*mund*” dhe njëkohësisht duke vendosur një afat të konsiderueshëm kohor për shqyrtimin e kërkesës, tregon qartë qëllimin e tij që nëpërmjet një procesi vlerësimi t’i japë diskrecion në vendimmarrje Këshillit. Kjo strukturë logjike, e hartimit të dispozitës, e cila kombinon foljen “*mund*” me afatin e paracaktuar, tregon qartë se qëndrimi në detyrë përtej moshës 67 vjeç është një mundësi ligjore, jo një detyrim i Këshillit, dhe se ky institucion ka të drejtën e vlerësimit nëse kërkesa e magjistratit duhet pranuar apo refuzuar në përputhje me qëllimin e ligjit dhe interesin e sistemit të drejtësisë.

14. Me qëllim ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit, në mungesë të parashikimeve të tjera ligjore, në Ligjin nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, i ndryshuar, rezulton se për Këshillin, legjislacioni i zbatueshëm, është Kodi i Procedurave Administrative, i cili ndër të tjera, në nenin 2, pika 1 të tij, parashikon se “*1. Ky Kod zbatohet kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative: a) vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ*”; ndërsa në nenin 3, pika 6 të tij, parashikon se “*Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 6. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike*”. Bazuar në këto dispozita, duke qenë se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është një organ i pushtetit qendror që ushtron funksione administrative dhe në këtë rast nxjerr akte administrative që vendosin për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, profili prokuror, atëherë parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, zbatohen edhe nga ky Këshill, qasje kjo që përforcohet edhe nga rregullimi i Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, neni 189, pika 3 e cila parashikon se “*Këshilli i*

*Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.*

15. Duke iu referuar rregullimeve të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton se ky i fundit, në nenin 3, pika 3 të tij parashikon se *“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... 3. “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik”,* ndërsa më tej në nenin 11, shprehet se *“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe; ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.*

16. Këto parashikime japin një bazë të mjaftueshme ligjore, për ushtrimin e diskrecionit nga anë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në vlerësimin e këtyre kërkesave, vlerësim i cili do të bëhet gradualisht dhe mbi bazën e precedentëve që do të vendosen rast pas rasti.

17. Duke iu kthyer edhe argumentit të fundit të dhënë nga shumica, rezulton se në këtë rast, ajo i referohet praktikës së mëparshme të Këshillit. Kjo praktikë, në fakt është vetëm një rast dhe konkretisht vendimi nr. 98, datë 19.5.2022, ku është miratuar shtyrja e moshës së daljes në pension për prokurorin P.M.<sup>4</sup>

18. Ne, si anëtarë në pakicë, për vetë ecurinë që pati ai rast, jemi të mendimit që nuk duhet të merret në konsideratë. Kështu, ky prokuror, ishte shkarkuar me nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe kundër këtij vendimi ishte paraqitur ankim. Pavarësisht këtij fakti, Këshilli, me vendimin e tij nr. 98, datë 19.5.2022, vendosi të miratojë shtyrjen e moshës së daljes në pension. Në një moment të dytë, me datë 19.3.2024, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, njoftoi se do të shqyrtonte ankesën e këtij subjekti në dhomë këshillimi me datë 22 prill 2025.<sup>5</sup> Ndërkohë, në mbledhjen plenare të datës 17 prill 2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, një prej anëtarëve paraqet për të shqyrtuar me urgjencë, një kërkesë të këtij prokurori për të dalë në pension (megjithëse nuk e kishte arritur moshën 70 vjeçare), për arsye shëndetësore. Mbas diskutimeve, anëtari që e paraqiti këtë propozim, e tërhoqi atë (duke deklaruar se ishte *“bindur në pabazueshmërinë e kërkesës së tij”*), ndërkohë që një tjetër anëtar e riparaqet. Më pas, mbledhja ndërpritet, çështja shqyrtohet në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe mbledhja rifillon, duke u votuar<sup>6</sup> dhe duke disponuar më pas Këshilli me vendimin e tij nr. 51, datë 14.4.2024, ku u vendos mbarimi i statusit të magjistratit për këtë prokuror.<sup>7</sup>

19. Ndodhur përballë kësaj situatë faktike, jemi të mendimit që qëndrimi i mëparshëm i Këshillit, nuk duhet të merret në konsideratë duke qenë se subjekti që përmendet në rastin e parë, ka marrë pagën sipas legjislacionit në fuqi, pa ushtruar funksionet e tij, pasi ishte shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në përfundim, pa u përballur deri në fund me vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, institucion që ishte investuar me ankimin e paraqitur prej tij, ky subjekt kërkoi që të dalë në pension, dëshirë kjo e plotësuar nëpërmjet një procedure kaotike nga ana e Këshillit. Në

<sup>4</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.-98-dt.-19.05.2022.pdf>

<sup>5</sup> <https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/03/Shpallje.pdf>

<sup>6</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/05/Pv-i-dates-17.04.2024.pdf>

<sup>7</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2024/04/v.nr\\_.51.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2024/04/v.nr_.51.pdf)

atë rast, megjithatë, nuk rezulton që nga ana e Këshillit të jetë analizuar aspak, dëmi që iu shkaktua buxhetit të shtetit.

20. Ne, si anëtarë në pakicë mendojmë se vendimmarrja e sipërcituar e Këshillit e vitit 2022 tregoi qartë një problematikë që nuk u adresua dhe konkretisht që buxheti i shtetit pagoi për një prokuror që nuk e ushtroi detyrën, sepse ishte i shkarkuar nga KPK dhe priste vendimin e KPA-së. Pra, pati pagesë pa një shërbim real. Kjo solli kosto shtesë për buxhetin të shtetit pa asnjë përfitim për sistemin. Kjo qasje bie ndesh me parimet bazë të administrimit financiar dhe konkretisht atë të efikasitetit dhe të përdorimit të kujdesshëm të fondeve publike.

21. Vendimmarrja e sotme e Këshillit, duket shumë e ngjashme me vendimmarrjen e mëparshme, duke qenë se kemi një vendim shkarkimi nga KPK, kundër të cilit është paraqitur ankim në KPA dhe kërkohet njëkohësisht shtyrja e daljes në pension. Shumica, e pranoi këtë kërkesë pa një vlerësim serioz të pasojave financiare duke rrezikuar përsëritjen e së njëjtës situatë.

22. Prandaj, si anëtarë në pakicë, nuk jemi dakord me miratimin e kërkesës në këto kushte, pasi Këshilli duhet të ushtrojë diskrecionin e tij vetëm kur është e qartë se zgjatja e qëndrimit në detyrë i shërbente vërtet interesit publik dhe me koston më të ulët të mundshme për buxhetin.

23. Për arsyet e mësipërme, miratimi i kësaj kërkesë nuk e konsiderojmë të arsyeshme.

**ANËTAR**

**Sokol Stojani**

**ANËTAR**

**Erind Merkuri**

<sup>1</sup> <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/05/Pv-i-dates-17.04.2024.pdf>

<sup>1</sup> [https://klp.al/wp-content/uploads/2024/04/v.nr\\_.51.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2024/04/v.nr_.51.pdf)